

# Arritja në Evropë


përpiluar nga redaktorët

Të dhënat më të hershme nga Evropa Jug-lindore | Burimet e hershme nga Evropa Qendrore | Romët si grupe të organizuara të pelegrinëve | Arsyet për migrimin në perëndim | Vala e parë: arritjet prej 1417 deri 1421 | Letrat e sjelljes së sigurt | Arritjet e mëtejme deri me 1435 | Mosbesimi dhe qortimet— blerja, dëbimi, përjashtimi

➤ Romët me gjasë veçse ishin duke jetuar në Perandorinë Bizantine, në territorin e Greqisë së sotme, para vitit 1200. Duke iu falënderuar numrit në rritje të të dhënave për romët nga popujt vendas nga viti 1400 e tutje, rrugët e tyre brenda Evropës sot mund të gjurmohen në mënyrë mjaft precize. Në vitin 1450, romët kishin udhëtuar gati në tërë Evropën. Në Evropën Qendrore, dëbimet the largimet veçse po ndodhnin në atë kohë. Shpejt kjo do të shpinte në persekutime të organizuara.

## REFERIMET E PARA TË ROMËVE NË EVROPË DERI NË VITIN 1600

Ill. 1 (bazuar në Tcherenkov/Laederich 2004, p. 83)




## PARATHËNIE

Nuk ka të dhëna të besueshme për historinë aziatike dhe historinë e hershme evropiane të romëve, por vetëm aluzione, interpretimi i të cilave, në masë të madhe, ende është një temë e diskutimit shkollor. Ndoshta kurrë nuk do të dimë

me siguri pse, si, apo edhe kur romët janë vendosur në Evropë për herë të parë. Në këtë aspekt, periudha prej vitit 1200 deri në 1500 sjell ndryshime të rëndësishme: nga shekulli i 14-të e tutje, dëshmitë bashkëkohore konstatojnë pa dyshim se njerëzit dhe grupet e përmendura sigurisht kanë qenë romë.

Në përgjithësi ekziston pajtimi se romët tanimë ishin duke jetuar në pjesët evropiane të Perandorisë Bizantine para shekullit të 13-të. Sidoqoftë, mbetet e paqartë, se kur saktësisht romët e parë janë nisur për në veri nga vendbanimet e tyre në Greqi. Ngjashëm, nuk e dimë pse dhe në çfarë



III. 2

Është thënë se njëra nga të dhënat e para të romëve në Evropë mund të gjendet në Kronikën e Vjetër të Czech Dalimil. Kjo kronikë, e datuar diku me 1310, përmend "skautët Tartar". Si në disa raste të tjera, lidhje e kësaj të dhëne me romët nuk diskutohet.

(Kjo kopje e Kronikës së Dalimilit mbahet në Bibliotekën Kombëtare të Vjenës)



III. 3

Farkëtari romë me ndihmësin, rreth vitit 1600.

(nga Gronemeyer / Rakelmann 1988, f. 122) (Detaj)

numri ata kanë braktisur Perandorinë Bizantine. Është shume e mundur se grupet e vetme kishin lëvizur në veri nga mesi i shekullit të 14-të e tutje. Së pari, dokumentet jo doemos drejtojnë kah romët, dhe mund të lexohen si dëshmi të grupeve tjera të njerëzve. Sidoqoftë, nga viti 1385 e tutje, ne kemi dëshmi të besueshme të romëve në Wallachia, në Rumaninë e sotme. Që nga ajo kohë, romët janë përmendur gjithmonë e më shpesh; këto dokumente tregojnë se si grupet e romëve kanë hulumtuar kontinentin evropian. Në vitin 1435, romët

tanimë njiheshin mirë në shumicën e qyteteve evropiane.[III. 1]

Njohuria e njerëzve të posa aritur nuk ishte ngritur në të njëjtën mënyrë sikurse numri i të dhënave për ta. Përmenden letrat e sjelljes së sigurt nga perandorët, mbretërit dhe papa, dhe për legjendat e pelegrinëve, që siguronin një pritje miqësore në fund të Epokës së Mesme, fuqimisht të formësuar nga Krishterimi. Shërbimet si falli dhe falli përmes duarve apo aftësitë e pandershme si vjedhja e xhepave gjithashtu përmenden – evro-

pianët vendas kanë parë vetëm atë që është shkruar ta shihnin. Apo atë çka dëshironin ta shihnin: Shumë nga burimet e hershme akuzojnë romët për imoralitet dhe paganizëm, apo për spiunim për turqit, dhe në përgjithësi japin një përshtypje të njerëzve "tradhtar" dhe "të pabesë", por pa ndonjë dëshmi. Kështu që të dhënat e hershme formojnë një pasqyrë të pastër të romëve; sidoqoftë është një pasqyrë e shtrembëruar, një karikaturë, që deri më sot ende formon pasqyrën jo-rome të romëve.

#### TË DHËNAT MË TË HERSHME NGA EVROPA JUG-LINDORE

Nga gjysma e shekullit 14-të e tutje, dokumentet evropiane nganjëherë përmenden grupet e njerëzve që nga shkollarët e hershëm gabimisht janë menduar të jenë romë. Për shembull, ekziston një dokument serb sipas të cilit Mbreti Stefan IV në vitin 1348 ia kishte dorë-

zuar manastirit të Prizrenit disa rrobaqepës, farkëtar, punues të shalave, dhe disa "C'ngari". Ishte thënë se këta të fundit ishin "Ciganë". Sidoqoftë, duket më bindëse se thjesht një zanat tjetër ishte në pyetje: në gjuhën mesjetare serbe, "c'ngar" kishte kuptimin e "këpucarit". [III. 2]

Dokumentet nga principatat e vjetra Rumune, Moldavia dhe Wallachia, që vazhdimisht përmenden dhuratat që përbëheshin nga shoqëri të tëra, janë

të parat që pa dyshim flasin për romët. Për shembull, Dani I, Duka i Wallachia, konfirmon disa dhurata për manastirin e Shën Marisë, Tismana, në vitin 1385, që gjithashtu përfshinte 40 "salashe" (shprehje e prejardhur nga turqishtja, që paraqet familjet ose komunitetet në tenda) të "Atigani" ("Ciganët"). Në Moldavinë fqinje, Aleksandri i Mirë kishte dërguar përmbi 31 "chelyadi" (shprehje e prejardhur nga sllavishtja, që gjithashtu ka kuptimin e "salash")



### Die Zigeuner nicht einzuladen noch zu gedulden.

Allen vnd pfeglichen Churfürsten, Fürsten, Pölaten, Grafen / Herren, vom Adel / auch den Stetten / des Bundes in Landt zu Schwaben / Ein  
bieten wir / Römischer Kayserlicher, vnd Hispanischer Küniglicher Mayestat, Churfürsten / Fürsten, vnd anderer Stände des Bundes zu Schwab  
ben, Botschafften / Haupteleuten, vnd Käse / vnz zu Din versamelt / vnser vnnderthänig willig vnd geflossen / Auch gürflüchlen grüß, vnd fründlich  
dienst / wie es dann, aims yeden Stände wesen nach bescheyden soll / zu vor. Vnd sügen ainem yedem Ständ, alle vorlartt zu wissen / Nach  
dem / wie meniglich waiffe, die Zigeuner, welcher emnd vnd out, ynn vnd ausserschalt des Bundes sy bis her, hin vnd wider gezogen, vnd sich ene  
halten vnd vnnderschlaufft, dem gemainen Mann, auf dem Landt, vnd sinft, vast schädlich vnd nachteilig gehandelt. Das wir demnach  
in bedacht desselben / Auch auf andern merren redlichen vnd beweglichen güeten Ursachen / für zimal nordürffig vnd güte angesehen vnd beschloß  
sen haben / Das sich solicher Zigeuner, billich entziffert, Vnd die in der Bundes Ständ Oberkauten vnd Gebieten mit eingelassen vnd geduldt wer  
den sollen / Vnd solichs hiemit ainem yeden Bundes Ständ vnuckfunde nit lassen wöllen / Vnd ersuchen darauf ainem yeden Bundes  
Ständ, wie sich das, aims yeden Ständs vnd wesen nach / gebüt, züm höchsten. Das sich ain yeder Bundes Ständ, vnd verwannder /  
Söllichen vnsern güeten bedennender vnd beschloß / gemeß halten / die Zigeuner, in seinen Fürstenthumben, Oberkauten, vnd Gebieten / nit einlas  
sen, gedulden, noch denen, ainichen enthalte vnd vnnderschlaufft, zu lassen noch gestatten / Sonnder die selben / austreiben, vnd verweisen. Vnd  
wa ainichen Bundes Ständ vnd verwannden / solichs züschwer sein wölte, vnd derselb / ainem andern / Vnd hillff vnd züzug defhalb ersuchen  
wölte / Dasselbig / Wie sich / vermög der Bundes Zünung gebüt, volziehen vnd lassen, vnd das nit vnderlassen wölte. Darnach  
sich ainicher Bundes Ständ in sollichem Zünung, förnig halten vnd erzeigen / Vnd darvurch dem andern / oder den Seinen / Schad vnd Nach  
teil ersticken / Würde wir verursache, denselben Schaden, an Tme, zu erholten / Geben / vnd mit vnser der Dreyen gemainen Haupt  
keipt Secret beschien, besigelle / Zü zwainzigsten tag, des Monats Nouembis, Anno. 1529. Neun vnd zwainzigste.

III. 4

“Die Zigeuner nicht einzuladen noch zu gedulden” (“Mos të ftohen as mos të tolerohen Ciganët”): Kjo letër e lëshuar në vitin 1529 nga federata e qyteteve, dukatave dhe regjioneve gjermane (“Schwäbischer Bund”) ka urdhëruar që “Zigeuner” (“Ciganëve”) tu ndalohej hyrja në territoret e tyre.

(nga Gilnsbach 1994, p. 137)

të “Tigani” dhe 12 tenda të “Tartarëve” manastirit të Bistrita. Në kundërshtim të dokumenteve të mëhershme, pa dyshim se ishin romët për të cilët bëhej fjalë. Rrjedhimisht, mund të arrihet në përfundim se romët ishin vendosur në Ballkan më së voni në pjesën e dytë të shekullit 14-të.

Në principatat e Danubit ata ishin mirëseardhur për shkak të aftësive të tyre. Me qëllim të ruajtjes së përhershme të faktorit thelbësor ekonomik që romët përfaqësonin, autoritetet dhe kisha shpejt i parandaluan nga udhëtimet. Me kohë, romët u bënë pronë e shtetit, kishës ose pronarëve të mëdhenj të tokave dhe u bënë skllav ose bujkrob për shekuj me radhë, derisa skllavëria u shfuqizua në Rumani në vitin 1856.

Arritja e romëve në Mbretërinë e Hungarisë gjithashtu nuk mund të saktësohet me një datë precize. Nga viti 1370 e tutje, fjala “Cigan” në disa variacione paraqitet si mbiemër, por kjo nuk do të thotë medoemos se ata që përdornin këtë emër ishin romë. Të pavarur nga koha e arritjes së romëve në Hungari, duhet të thuhet se romët ishin pranuar

me një shkallë më të lartë të tolerancës në Hungari sesa në shtetet tjera. Njohuria e tyre për përpunimin e metalit dhe prodhimin e armëve i bëri ata shumë të kërkuar, dhe ata ishin të mbrojtur nga mbreti. Shfrytëzimi privat i shërbimeve të tyre duhet të miratohej nga mbreti. Për shembull, në vitin 1476 qytetarët e qytetës Herrmannstadt duhej të merrnin lejen e Matthias Corvinus para se të lejoheshin të merrnin romët të punonin në periferi. [III. 3]

#### TË DHËNAT MË TË HERSHME NGA EVROPA JUG-LINDORE

Një shënim në “Hildesheimer Stadtrechnung” (libri i shpenzimeve), që daton nga viti 1407, zakonisht mendohet të jetë dëshmia më e vjetër e paraqitjes së romëve në Gjermani. Ai thotë se “am 20. September den Taren ... für einen halben Stüber Wein gegeben eurde” (me 20 shtator, ca verë iu kishte dhënë tartarëve). Kërkimi i kohëve të fundit ka treguar se njerëzit e përmendur në këtë shënim me gjasë

nuk kanë qenë romë. Sidoqoftë, emri “Tartars”, që ishte përdorur për romët së paku që nga shekulli i 15-të e tutje, ende përdoret në Gjermaninë veriore dhe Skandinavi.

Në vitin 1414, “Wochenausgabebücher” (libri i shpenzimeve javore) i qytetit të Bazelit përmend një “pagan” të cilit, “me mirësinë e Zotit”, qyteti i kishte dhënë 10 shilingë. Gjithashtu në këtë rast nuk është e sigurtë nëse kjo i referohet ndonjë romi, pasi që në atë kohë të gjithë të huajt janë quajtur “paganë”. Sidoqoftë, në vitet dhe dekadat që pasuan shprehja “pagan” pa dyshim është përdorur si sinonim për “Ciganët” në territorin ku flitej gjermanishtja.

“Ciganët” gjithashtu u paraqitën në Hesse në vitin 1414. Sidoqoftë, shënimet për arritjen e tyre në “Hessische Chronik” (Kronika e Hesses) ishte bërë vetëm 200 vjet pas ngjarjes, kështu që data mund të mos jetë plotësisht e saktë. Sipas “Meißner Chronik”, që gjithashtu ishte shkruar në një datë më të vonshme, deri në vitin 1416 “Zigani” veçse ishin dëbuar nga markanti.





III. 6

Pelegrinët romë. Gravura nga Jacques Callot, 1622

(nga Hancock 1987, f. 15) (Detaj)

## ROMËT SI GRUPE TË ORGANIZUARA TË PELEGRINËVE

Nga viti 1417 e tutje, kronistët e një numri të vendeve evropiane kanë shënuar arritjen e romëve, të cilët quheshin – varësisht nga njohuria e kronistëve dhe informata e dhënë nga të ardhurit e rinj – “tartarët”, “Egjiptasit”, “Egjiptleut”, “paganët”, “Saracenët” apo – tanimë – “Ciganët”.

Në qytetet e Evropës qendrore dhe perëndimore romët u paraqitën në grupe të mëdha, të udhëhequr nga njerëz me tituj fisnikësh, dhe fituan statusin e pelegrinëve. Sipas përshkrimeve bashkëkohore, “grupe të tilla të pelegrinëve” përbënin 30, 100 e nganjëherë dhe përmbi 300 njerëz, që udhëtonin në këmbë ose me kuaj. Nëse u ndalohej hyrja në qytete, ata kampionin në vende të hapura afër qyteteve. Udhëheqësit e tyre e quanin veten “dukë”, “kontë” apo “voivode”. Ata kishin kompetenca ndaj shoqëruesve të tyre, vishnin tesha më të mira sesa pjesa tjetër e grupit të tyre, dhe gjithmonë udhëtonin me kuaj. [III. 6]

Sipas kronistëve, udhëheqësit përfaqësonin veten zyrtarisht para

gubernatorëve të qyteteve me arritjen e tyre. Shpesh, ata mund të tregonin letrat e sjelljes së sigurt apo e rekomandimit nga udhëheqësit religjioz apo laik, të cilët u garantonin atyre siguri dhe mbrojtje ndaj sulmeve. Motivimi i supozuar religjioz për udhëtimin e tyre iu ka mundësuar të pranohen në mënyrë miqësore dhe mikpritëse. Në këtë aspekt, obligimi për ti furnizuar pelegrinët me ushqim, banim dhe para, një obligim që merrej shumë seriozisht nga shoqëria mesjetare, iu përshtatej shumë. Shënimet në libra të ndryshëm të shpenzimeve tregojnë se kjo detyrë Krishtere është përmbushur kudo, së paku në paraqitjen e parë të romëve.

Në mënyrë që të ishin pelegrinë të besueshëm, romët luanin tregime të pendimit që linin një përshtypje shumë të madhe. Romët shpesh arsyetonin bredhjet e tyre si pelegrinazh pendestar shtatë vjeçar, që iu ishte imponuar atyre për shkak se përkohësisht ishin ndarë nga Krishterimi. Më vonë, dy arsye ishin shtuar: refuzimi për të pranuar Xhozefin dhe Marinë, dhe ikja e izraelitëve nga Egjipti.

Ideja për të prezantuar veten – në dobi të tyre – si pelegrinë kur braktisën Greqinë me gjasë ka lindur

## TË ZINJTË SIKURSE TARTARËT

Sipas një murgu dominikan, Hermann Korner, ishin diku rreth 300 njerëz, burra dhe gra që e quanin veten “Secaner”, të cilët ishin “të tmerrshëm për tu shikuar” dhe “të zinj si tartarët”. Sipas murgut ata udhëhiqeshin nga një dukë dhe një kont të cilët kishin kompetenca mbi ta. Ata “Secaner” kishin paraqitur letrat e sjelljes së sigurt nga princat, kryesisht nga Sigismund, perandori i shenjtë romak, dhe kështu ishin trajtuar “në një mënyrë mikpritëse”. Kronisti shpjegon faktin se ata ishin vendosur jashtë mureve të qytetit: shumica nga ta ishin vjedhës dhe rrezikonin të arrestoheshin në qytet. Me sa duket letrat e sjelljes së sigurt nuk mjaftonin për mbrojtjen e romëve

nga kontakti me ata të krishterë të cilët përkohësisht qëndronin në Epir dhe në Peloponez në udhëtimin e tyre për në Tokën e Shenjtë. Gjithashtu “Egjipti i vogël” i cili, në burimet nga viti 1418 e tutje është konsideruar vendi i origjinës së romëve, ishte vendbanimi i “Ciganëve” në “Gyppe” afër Modonit (Peloponez). “Egjipti i vogël” (një zonë në Peloponez) për një kohë ishte kuptuar si Egjipti “i vërtetë” – vendi i Nilit – nga kronistët. E ndërlikuar me këtë gabim është shprehja e gabuar që përdorej për të përshkruar romët, “Egjiptas”, një shprehje me shumë variacione (“Ciganë”, “Gitan”, “Egjipter”) që ende është shprehja më e zakonshme për romët.

Është e mundur që në fillim vetëm një numër i kufizuar i romëve udhëtuan në Evropë: shënimet për romët në qytetet dhe regjionet fqinje ndodhin për intervalet e shkurta kohore, dhe emrat e udhëheqësve (Andreas, Michael) mbeten të njëjta. Shënimet e ndryshme lidhur me numrin e tyre shpëjnë në supozimin se vetëm bërthama e grupit kanë qëndruar bashkë gjatë gjithë kohës. Grupet më të vogla duket të jenë ndarë nga të tjerët dhe shkuar në rrugë të ndryshme.

ndaj masave ndëshkimore në qytezat e Hansas në rast të vjedhjes së pretenduar ose dëshmuar. Nuk është e qartë nëse autoritetet shqiptonin dënime më të ashpra apo popullata kërkonte hakmarrje. Sidoqoftë, një pjesë e këtij grupi u zhvendos në Gjermaninë jugore në muajt e parë të vitit 1418. Thuhet se qyteti i Frankfurtit iu kishte dhënë “atyre njerëzve të mjeruar nga Egjipti i vogël” 4 funt dhe 4 shilingë për bukë dhe mish në qershor të atij viti. Shënimi përkatës është përmendja më e hershme e “Egjiptit të vogël” si vendlindja e romëve.

III. 5

(ekstraktuar dhe përkthyer nga Gilsenbach 1994, f. 49f.)



III. 6

Pelegrinët romë. Gravura nga Jacques Callot, 1622

(nga Hancock 1987, f. 15) (Detaj)

## ARSYET PËR MIGRIMIN NË PERËNDIM

Migrimi i romëve në Evropën qendrore dhe perëndimore rastis me pushtimin turk në Evropën jug-lindore. Gjatë pushtimit të Ballkanit Turqit shkatërruan qytetet, qytezat dhe manastiret. Zona të tëra ishin rrënuar. Duket shumë e logjikshme që romët kishin braktisur zonat të cilat veçanërisht ishin prekur nga lufta.

Sidoqoftë, shumica e romëve, qëndruan në zonat që u futën nën pushtimin turk. Një arsye për këtë ishte se romët ishin skllavëruar në principatat Danubiane. Gjithashtu situata e romëve me gjasë nuk ishte përkeqësuar nën pushtimin otoman (krahasuar me pushtuesit e mëhershëm). Pavarësisht nga shënimet përkatëse në tekstet burimore, një motivim religjioz për migrim është shumë i mundshëm, posaçërisht për shkak se otomanët ishin shumë më tolerant ndaj atyre të besimit tjetër sesa, për shembull, mbretëritë krishtere në Evropë. Është shumë e mundur që romët kanë shfrytëzuar motivimin religjioz, duke ikur nga “të pafetë”, kryesisht si një mjet për tu siguruar që të

pranohen në mënyrë miqësore nga popullata e krishterë.

## VALA E PARË: ARRITJET PREJ 1417 DERI 1421

Me 1417, një grup i romëve udhëtuan përmes Lueneburg, Hamburg, Luebeck, Wismar, Rostock, Stralsund, dhe Greifswald. Murgu dominikan Hermann Cornerus raporton për njerëz të huaj udhëtues, deri atëherë krejtësisht të panjohur, të cilët kishin ardhur në numër të madh nga lindja në Alamannia, dhe kishin udhëtuar në bregun gjerman. Kështu që, “Kronikoni” i tij ofron raportin e parë gjithëpërfshirës rreth arritjes së një grupi të madh të romëve. [III. 5]

Diku rreth kohës së njëjtë, “Ciganët” u paraqitën në Alsace. Në kronikën e qytetit të Strasburgut, e shkruar vetëm në shekullin e 16-të, viti 1418 raportohet si vit i arritjes së “Zeyginger”; ata “kishin mjaft para dhe nuk lëndonin askënd”. Ata kishin ardhur – sipas kronistit – nga “Epiri”, “i quajtur Egjipti i vogël nga njerëzit e rëndomtë”.

Informata më të besueshme dhe më të sakta vijnë nga Colmar. Ky qytet ishte vizituar nga rreth 300 “paganë”

në gusht 1418, të pasuar me edhe 100 të tjerë, tri ditë pas largimit të grupit të parë. Përveç vrojtimeve tanimë të njohura, vathët e romëve, kostumet e veçanta të veshura nga gratë dhe aftësia e tyre në fall, ishin shënuar për herë të parë.


Për vitin 1418, gjithashtu ekzistojnë shënime për arritjet në Zvicër; atëherë, numri i arritjeve në Francë u ngrit. Me 22 gusht, 1419, “Saracenët”, të udhëhequr nga “Duka André i Egjiptit të vogël” u paraqitën në Chatillon-en-Dombes. Në janar 1420, “Duka Andreas” dhe 100 shoqëruet arritën në Bruksel. Në mars të të njëjtit vit, arritja e tyre është raportuar në Deventer (Holandë). Është e mundur që ky grup është i njëjtë si ai i raportuar në Francë. Sidoqoftë, nuk mund të jemi absolutisht të sigurt. Në vitin 1421, arritjet janë raportuar në Bryzh dhe Mons, ky i fundit madje ishte vizituar dy herë. Me 8 tetor, 80 njerëz, të udhëhequr nga “Duka Andreas i Egjiptit të vogël”, kishin arritur dhe paraqitur një letër të sjelljes së sigurt të lëshuar nga perandori Sigismund. Me 20 tetor, grupi i dytë pasoi, udhëheqësi i të cilit quhej Michael dhe i cili pretendonte të ishte vëllai i Andreasit të lartpërmendur. [III. 1]

*Nga letra e sjelljes së sigurt të Mbretit Sigismund, e lëshuar me 17 prill, 1423, në Zips (Slovakia):*

“Ladislausi jonë besnik, Cigani Voivode, dhe ata të cilët varen nga ai, në mënyrë të përlulur kanë kërkuar nga ne tu tregojmë vullnetin Tonë veçanërisht të mirë. Na vjen mirë të dëgjojmë kërkesën e tyre të respektueshme, dhe të mos refuzojmë letrën e tyre. Kur Ladislaus i lartpërmendur dhe njerëzit e tij shfaqen në ndonjë qytezë të perandorisë Sonë, ne rekomandojmë tu tregohet atyre besimi juaj ndaj Neve. Ju do t’ju ofroni çfarëdo mbrojtje, ashtu që Voivode Ladislaus dhe ciganët e tij, subjektet e tij, të mund të qëndrojnë brenda mureve tuaja pa u përballur me vështirësi. Nëse ka njerëz të tjerë në mesin e tyre, ose nëse ndodh ndonjë incident i pakëndshëm, atëherë është dëshira Jonë dhe Ne urdhërojmë qartësisht që vetëm Voivode Ladislaus, me përjashtim të gjithë juve, ka të drejtë të dënojë ose lirojë.”

III. 8

(përkthyer nga Mayerhofer 1988, f. 13)



III. 7

*Letra e sjelljes së sigurt nga Mbreti Friedrich III për Kontin Michel, 15 Prill, 1442.*

(nga Gilsenbach 1994, f. 81)

## LETRAT E SJELLJES SË SIGURT

Burimet shpesh raportojnë se udhëheqësit e romëve mbanin letra të sjelljes së sigurt me arritjen e tyre. Dokumentet e tilla iu paraprin pasaportave të sotëm dhe iu ishin lëshuar një personit (në këtë rast duka ose voivode) ku bartësve dhe shoqëruesve të tij u garantohet një udhëtim i lirë dhe i sigurt. Vërtetësia e këtyre letrave mund të vihet në dyshim. Por edhe pse letrat e tilla ishin dubluar dhe kaluar nga një grup në grupin tjetrin, ose – siç ishte e zakonshme në Mesjetë– dokumentet e falsifikuara qarkullonin, nuk ka dyshim se romët gjithashtu kishin dokumente të vërteta të udhëtimit në posedimin e tyre.

Një letër e sjelljes së sigurt padyshim e vërtetë dhe vazhdimisht e përmendur është njëra e lëshuar nga Mbreti Sigismund gjatë Këshillit të Konstancës (1414 – 1418). Në këtë dokument, udhëheqësi më i lartë laik i Krishterimit iu kishte dhuruar romëve, të cilët kishin thënë për vete se “paraardhësit e tyre kishin braktisur besimin në Egjiptin e vogël”, “përcjellje dhe një udhëtim i lirë përgjatë fshatrave dhe qyteteve të tij”.

Sebastian Münster, i cili kishte parë një kopje të kësaj letrë pas disa dekadave, raporton Lindaun si vend të lëshimit në librin e tij “Cosmographia universalis”, të botuar me 1550, por nuk përmend një datë precize.

Përveç letrave mbretërore të sjelljes së sigurt, romët gjithashtu kishin në dispozicion letra të tilla nga dinjtarët tjerë laik. Garancitë nga princat individual kishin përparësi, posaçërisht në zonat jashtë Perandorisë së Shenjtë Romake, ku letrat mbretërore nuk vlenin.

Marrë parasysh përçarjen e Evropës dhe obligimin pasues për të kërkuar mbrojtje në shumë principata dhe mbretëri të pavarura, romët shpejt kërkonin një letër të rekomandimit që do të ishte e vlefshme kudo. Në atë kohë një dokument i tillë do të mund të lëshohej vetëm nga përfaqësuesi i pushtetit të dytë universal – papa. Raporti i parë i letrës së rekomandimit të papës daton nga viti 1422. Pavarësisht nga vërtetësia e saj, është shumë e mundur të jenë bërë shumë kopje. Emrat ndryshues të marrësit dhe mospërputhjet në përmbajtje i bëjnë këto dokumente gjoja të papës të duken shumë të dyshimta. [III. 10]

Një dokument i ri ishte mbajtur nga grupi i parë i romëve të cilët kis-

hin arritur në Regensburg në vitin 1421. Ishte një letër e sjelljes së sigurt, me gjasë e vërtetë, e Mbretit Sigismund, të lëshuar në Zips në vitin 1423 Voivodës Ladislaus dhe “Ciganëve” të tij. Në këtë letër, Sigismund jo vetëm që i dhuron Ladislausit të lartpërmendur mbrojtjen e tij personale, por ai gjithashtu konfirmon kompetencat e Ladislaus ndaj shoqëruesve të tij. Gjithashtu ekzistojnë dëshmi të mëtejme se nuk ka pasur lidhje në mes këtij grupi dhe grupeve të përmendura më parë. Emri i voivodes, i cili qartësisht quhet përcjellësi i besueshëm i mbretit, zakonisht paraqitet në Hungari dhe Poloni; nuk ka indikacione të pelegrinazhit ose origjinës së “Ciganëve”; kjo shpie në supozimin se ata tanimë kishin qenë në Hungari për një kohë. Me gjasë ata kanë qenë pjesë e valës së dytë të imigrimit i cili ndodhi në një kontekst krejtësisht të ndryshëm. [Illa. 7, 8]

## AUTRES ARRIVÉES JUSQU'EN 1435

Një nga raportet më gjithëpërfshirëse dhe të gjalla të këtyre kohërave të hershme është ofruar nga një qytet-




### TREGIM NGA NJË QYTETAR ANONIM I PARISIT

*Sipas shpjegimeve borgjeze, me 29 gusht një avangardë prej 12 veta-ve ishte përcjellë nga një grup i madh prej më shumë se 100 burra, gra dhe fëmijë. Autoritetet iu refuzuan hyrjen në kryeqytet, por iu caktoj një vend të kampojnë afër faltores të Shën Denisit, që në atë kohë gjendej në veri të qytetit. Me sa duket, romët tërhoqën shumë vëmendje; autori i ditarit gjithashtu përmend se njerëz kureshtarë nga gjithë Parisi shkuan për ti shikuar ata. Ai plotëson një përshkrim të gjerë të shikimeve të tyre me një numërim të të gjitha akuzave që ishin bërë kundër të huajve (fall, vjedhje, magji,...) – por ai thotë se nuk mund ti konfirmoj ato. Kur thashethemet e praktikave “anti-krishtere” të romëve arritën në vesh të peshkopit të Parisit, ai shpejtoi për në kampin e romëve dhe i shkishëroj të gjithë ata që u kishin treguar falltarëve duart e tyre. Shkishërimi i romëve dukej i panevojshëm, pasi që peshkopi i konsideronte “pagan”, pavarësisht nga letra e sjelljes së sigurt të lëshuar nga papa. Ata thjesht u dëbuan nga La Chapelle (faltorja). Përshkrimi i këtyre ngjarjeve përfundon me shënimin se romët kishin lëvizur në drejtim të Pontoise me 8 shtator, 1427.*

III. 9

(ekstraktuar dhe përkthyer nga Gilsenbach 1994, f. 68f.)



III. 10

*Njëra nga letrat e sjelljes së sigurt të lëshuar nga papa për romët, supozohet se kjo ishte lëshuar nga Papa Martini V në vitin 1483. (nga Hancock 2002, f. 30)*

ar anonim në Paris. Në shkrimin e tij “Journal d’un bourgeois de Paris” ai përshkruan se si, me 17 gusht, 1427, në 12 “pendimet” e para– “një dukë, një kont, 10 njerëz, të gjithë me kuaj” – kishin ardhur në portat e qytetit të Parisit, në atë kohë të pushtuar nga anglezët, dhe kishin paraqitur një letër të sjelljes së sigurt nga Papa Martini V. Ata thonin se kishin bërë një pelegrinazh në Romë për ti rrëfyer mëkatet e tyre – ata kishin braktisur besimin e tyre dhe kështu ishin dëbuar nga vendbanimi i tyre. Pendesa e papës ka qenë të bredhin rreth botës për shtatë vjet “pa fjetur në shtrat”. [III. 9]

Vetëm pas 3 javëve, një “Kont Thomas”, i shoqëruar nga përafërsisht 40 njerëz, duke ardhur nga një “vend i huaj dhe shumë i largët”, u paraqit afër Amiens. Pas një ekzaminimi të plotë të letrës të sjelljes së sigurt të papës këshilli vendosi ti lejoi të huajt në qytet dhe tu jap “8 livres parises” nga arka e qytetit si lëmshë. Data, formulimi gati identik i historisë së treguar, dhe letra nga Martin V, që përmendet edhe një herë, shpiti në supozimin se Konti Thomas dhe udhëheqësi i romëve afër La Chapelle, i cili nuk ishte përshkruar në hollësi, ishte njëri dhe i njëjti person.

Në vitin 1429, qyteti holandez i Deventer, dhe distriktet tjera të autoritetit lokal holandez kishin akomoduar njerëzit nga “Egjipti i vogël”. Shënimi përkatës në libra është interesant në atë se për herë të parë, shprehja “pagan” ishte përdorur në Holandë. Që nga ajo kohë, kjo shprehje ka qenë emërtim i zakonshëm për romët.

Vizitat në Thüringen dallohen nga arritjet tjera në tokën gjermane. Romët të cilët kishin arritur në Erfurt (in 1432) dhe në Meiningen (in 1435) nuk duket të kenë ndonjë lidhje me grupet e përmendura më parë. Me gjasë, ata gjithashtu i përkisnin valës së dytë të imigrantëve që vinin nga Hungaria.

### MOSBESIMI DHE QORTIMET– BLERJA, DËBIMI, PËRJASHTIMI

Deklarimi i udhëtimit të tyre si pelegrinazh, si dhe letrat e tyre të sjelljes së sigurt, iu siguruan romëve një pranim miqësor në paraqitjen e tyre të parë në Evropën qendrore dhe perëndimore. Sidoqoftë, “Ciganët” u konsideruan si të dyshimtë që nga fillimi nga popullata vendase, posaçërisht në ato vende ku fli-

tej gjermanishtja. Shumë shpejt, paraqitja e tyre e huaj, siç ishte lëkura “e zezë” dhe pamjet e tyre të “tmerrshme” u shoqëronin me tiparet e karakterit negativ dhe sjelljes së papërshtatshme shoqërore. Ekzistojnë vetëm disa përshkrime neutrale, por një numër i madh dhe vazhdimisht të përmendura ishin ato negative.

Tanimë në burimet e hershme romët u prezantonin si njerëz të egër, të pasjellshëm dhe pagan. Veprat e vogla kundër pronës dhe mashtrimet ishin në rrënjë të reputacionit të keq të romëve si “vjedhës dinak”. Falli, që me sa duket kishte qenë si mbulesë për vjedhësit e xhepave, ngriti pakënaqësinë e autoriteteve religjioze. Përfaqësuesit e kishës supozonin se pas lojërave të romëve fshihej “magjia” dhe frikësoheshin për shpëtimin shpirtëror të besimtarëve të tyre.

Edhe pse vjedhja dhe falli shpesh ishin shënuar në burime dhe menjëherë stilizuar si karakteristikë etnike, nuk ka dëshmi që romët kishin punuar si spiunë për turqit, siç është pretenduar shpesh. Edhe pse asnjë romë nuk mund të fajësohej për spiunazh, pasqyra e romëve si njerëz “tradhtarë dhe të pabesë” hyri në ekzistencë dhe vazhdoi të ekzistoj me shekuj.



III. 11

Vizita e Ciganëve. Krijuesi i panjohur, c.1490. Tapicieri e leshit.

(nga Fraser 1992, f. 101)

Madje në arritjen e tyre të parë, romët u toleruan nga populli vendas vetëm për një periudhë të shkurtë kohore. Pas një periudhe gjatë së cilës të huajt ishin pranuar në mënyrë (pak a shumë) mikpritëse, popullsia vendase tentoi ti mbante larg qyteteve. Lëmosha aq e përmendur “për të nderuar Zotin” u shndërrua në një mënyrë të “blerjes” së prezencës së bezdisshme të pelegrinëve. Rasti i parë i tillë ishte në Bamberg. Kronika e qytetit raporton se në vitin 1463, një dhuratë prej

7 funt iu kishte dhënë “Ciganëve”, “darum, dass sie von stund an hin ägeschieden und die gemein unbeschädigt liessen” (ashtu që të braktisnin qytetin brenda një ore dhe të mos sillnin dëm në qytet).

Kur “Ciganët” u kthyen – pavarësisht ndalesave për të hyrë, pavarësisht kërcënimeve për shkishërim që më vonë edhe ishin kryer, pavarësisht nga dëbimet dhe “blerjet” –përgjashtimet e para të dhunshme u ndërmorën. Për shkak të mosbesimit të

rritur dhe qëndrimit gjithnjë e më armiqësor të popullatës ndaj të huajve, autoritetet lokale dhe shteti ndërmorën hapa drastik. Dekreti i zgjedhësit Albrecht Achilles të Brandenburgut i vitit 1482, që u ndalonte “Ciganëve” qëndrimin në territorin e ti, dhe deklarata gjatë “Reichstag” (seanca parlamentare) në Lindau, me 1497, që i konsideronte “Ciganët” kriminel, ishin hapat e parë drejt “ndjekjes së Ciganëve” në shkallë të madhe. [III. 4]

## Bibliografia

**Fraser, Angus (1992)** *The Gypsies*. Oxford / Cambridge: Blackwell | **Gilsenbach, Reimar (1994)** *Weltchronik der Zigeuner. Teil 1: Von den Anfängen bis 1599*. Frankfurt am Main: Peter Lang | **Gronemeyer, Reimer / Rakelmann, Georgia A. (1988)** *Die Zigeuner. Reisende in Europa*. Köln: DuMont Buchverlag | **Hancock, Ian (1987)** *The Pariah Syndrome. An account of Gypsy slavery and persecution*. Ann Arbor, Michigan: Karoma Publishers | **Hancock, Ian (2002)** *We are the Romani People. Ame sam e Rromane džene*. Hatfield: University of Hertfordshire Press | **Mayerhofer, Claudia (1988)** *Dorfzigeuner. Kultur und Geschichte der Burgenland-Roma von der Ersten Republik bis zur Gegenwart*. Wien: Picus Verlag | **Tcherenkov, Lev / Laederich, Stéphane (2004)** *The Rroma. Volume 1. History, Language and Groups*. Basel: Schwabe Verlag | **Vossen, Rüdiger (1983)** *Zigeuner. Roma, Sinti, Gitanos, Gypsies zwischen Verfolgung und Romantisierung*. Frankfurt am Main: Ullstein